

Gjykata e Apelit e ka kthyer në rivendosje çështjen e paraburgimit të imami të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, Shefqet Krasniqit. Lajmi është konfirmuar nga Sevdali Zejnullahu, avokat i Krasniqit.

Sipas tij, mbrojtja e ka pranuar vendimin me të cilin çështja është kthyer në rivendosje dhe pritet që në ditët në vijim Gjykata Themelore në Prishtinë të vendosë për këtë rast.

Imami Krasniqi është arrestuar më 17 shtator nën dyshimet për vepra penale kundër rendit kushtetues dhe të sigurisë të Republikës së Kosovës.

Kjo është hera e dytë që rasti i paraburgimit të Shefqet Krasniqit kthehet në rivendosje.

Herën parë, pak ditë pas caktimit të masës së paraburgimit, ankesa e avokatit të tij ishte miratuar nga Kolegji i Apelit, por Gjykata Themelore e kishte konfirmuar masën e caktuar të paraburgimit./kallxo.com/